

KONTRATË SHIT- BLERJE PASURI E LUAJTËSHME

(KUOTAT E SHOQËRISË “Re/Born” SHPK)

Sot më datë 27.05.2022, në ambjentet e shoqërisë “Re/Born” SHPK me NUIS L71309019P dhe adresë Rruga "Endri Keko", shk. 3/1, ap. nr. 6, Tiranë u ra dakort si me poshte:

SHITËS:

Z. OLSI IBRO, datëlindja 01.03.1978, banues në Tiranë, i identifikuar me Letërnjoftim ID me nr. 036331327 dhe me nr.personal H80301195A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar; (këtu e më poshtë “pala shitëse/ Shitësi”)

BLERËS:

Z. ABDULLA BIÇAKU, datëlindja 16.04.1950, banues në Tiranë, i identifikuar me Letërnjoftim ID me nr. 033281283 dhe me nr.personal F00416038V, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar; (këtu e më poshtë “pala blerese/ Bleresi”)

Të cilët vendosin të lidhin këtë kontratë me kushtet dhe termat e mëposhtme, bazuar në :

- *Parashikimet e Kodit Civil të Rrepublicës së Shqipërisë;*
- *Ligji nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” i ndryshuar;*
- *Ligji nr. 9887, date 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dbënave personale”;*

Neni 1 Parashtesat

Meqënëse ekzistojnë këto kushte paraprake:

1.1 Shitësi është pronar i 1,00 kuota dhe 51% te pjesëmarrjes në Shoqërinë “Re/Born” shpk (këtu e më poshtë “Shoqëria”), me NIPT L71309019P me seli ne Rruga "Endri Keko", shk. 3/1, ap. nr. 6, Tiranë. Numri i përgjithshëm i kuotave është 2,00 dhe shitësi është 51% pronar i këtyre kuotave të pjesëmarrjes të kapitalit të Shoqërisë “Re/Born” shpk;

1.2 Meqënëse për transferimin e kuotes të kapitalit është dhënë miratimi formal nga ana e asamblesë së ortakëve të Shoqërisë me vendimin datë 27.05.2022, bashkëlidhur kësaj kontrate;

1.3 Meqënëse shoqëria është aktive në organet tatimore dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në aktivitet të plotë ekonomik dhe financiar, mbi kuotat e kapitalit të saj apo ortakëve të vecantë nuk ka asnjë ndalesë ligjo-re, pengese, inskriptim apo kufizim,

Palët kërkuan lidhjen e kësaj kontrate shitblerje kuotash kapitali me permbajtjen që vijon.

Neni 2 Objekti i kontratës

2.1 Shitësi deklaron se është zotëruar i 1,00 kuota pjesëmarrjeje në kapitalin e shoqërisë ose 51% (pesëdhjetë e një përqind) pjesëmarrës në kapitalin e zotëruar në shoqëri të cilat ja shet palës blerëse, e cila është plotësisht dakort për këtë.

2.2 Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate Shitje nga palët dhe regjistrimit të saj në QKB, përbërja e shoqërisë “Re/Born” shpk do të jetë: Abdulla Biçaku zotëruar i 100% të kuotave.



Neni 3
Cmimi i shitjes

3.1 Vlera e shitjes për kuoten e kapitalit me nje vlere nominale 500,00 Lek do te jete ne cmimin sipas Aneks 1, bashkëlidhur kontratës së shitjes.

Neni 4
Mënyra e pagesës

4.1 Palët deklarojne se cmimi total i shitjes për kuotat e kapitalit që zotëron shitësi në këtë shoqëri është likujduar totalisht nga blerësi.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e shitësit

5.1 Shitësi garanton pronësinë e tij të plotë mbi kuoten e kapitalit objekt i kësaj kontrate shitjeje, si dhe garanton se ajo është e lirë nga barra e cfaredolloj natyre, vese, detyrime fiskale, të drejta apo pretendime të të treteve, apo kufizime te tjera.

5.2 Shitësi deklaron se ka vënë në dispozicion të blerësit të gjithë informacionin përkatës për shoqërine kuotat e të cilës janë objekt i kësaj kontrate shitblerje.

5.3 Shitësi detyrohet të lejojë Blerësin të gezojë lirisht kuotat e kapitalit objekt i kësaj kontrate pa asnjë pengese.

Neni 6
Të drejtat dhe detyrimet e blerësit

6.1 Blerësi detyrohet të paguajë Shpenzimet për kalimin e kuotave të kapitalit objekt i kësaj kontrate dhe shpenzime të regjistrimit të kontratës ne QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit)

6.2 Blerësi detyrohet te pajiset me te gjitha lejet dhe licensat e nevojshme per ushtrimin e aktivitetit sipas objektit te Shoqerise.

Neni 7
Rregjistrimi në QKB

7.1 Palët u vunë në dijeni se këtë kontratë duhet ta regjistrojnë në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit (Biznesit) në bazë të Nenit 43 te Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “PËR QENDRËN KOMBËTARE TË RËGJISTRIMIT”.


Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

8.1 Palët bien dakort që cdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do te zgjidhet me mirëkuptim. Ne rast te kundert Palet do t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9
Dispozita te fundit

9.1 Pala Shitëse humbet të drejtën e pronësisë mbi kuotat e kapitalit në këtë shoqëri të drejtë të cilën e fiton pala blerëse mbas nënshkrimit të kësaj kontrate.

9.2 Kësaj Kontrate i bashkëngjiten 1 vendim i asamblese së ortakëve të shoqërisë, 1 Ekstrakt Historik të QKB për



shoqërinë dhe dokumenta identifikimi të palëve

9.3 Kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali hartohet në tre kopje nga të cilat dy prej tyre ju jepen palëve dhe tjetra dërgohet në QKB për ndryshimet përkatëse.

Kontrata ju lexua palëve me zë të lartë dhe qartë në gjuhën Shqipe, u kuptua prej tyre dhe meqënëse shprehën vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë e nënshkruan atë pa pretendime.

PALËT:

SHITËS
Olsi IBRO



BLERËS
Abdulla BIÇAKU

A handwritten signature in blue ink that reads 'Abdulla Biçaku'.

ANEKS 1

Cmimi i shitjes

Cmimi i plotë i shitjes së 51% të kuotave që Z. Olsi IBRO tjetëron/shet në favor të Z. Abdulla BIÇAKU është kryer në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate Shit-Blerje nga palët.